



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, Datë: 20 prill 2010
Ref. Nr.: RK14 /10

VENDIM

Rasti Nr. KI 23/09

Ahmet Arifaj
kundër
Komunës së Klinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese në përbërje:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtare
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës, Ahmet Arifaj, nga Klina.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Komuna e Klinës.

Subjekti i Lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Kuvendi Komunal i Klinës nxori një vendim të pafavorshëm për kompensimin e pronës së dëmtuar gjatë viteve 1998/99 në Kosovë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Kushtetuta); neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Ligji), dhe nenit 54(b) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e më tutjeshëm Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës

5. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi Kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese më 30 qershor 2009. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtarit Raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues, në përbërje të Gjyqtarëve Enver Hasani (Kryesues), Gjylieta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, i rekomanduan Gjykatës në përbërje të plotë kundërshtimin e lëndës si të papranueshme, po atë ditë.

Faktet

6. Nga dokumentet e parashtruara nga ana e Parashtruesit të kërkesës vërehet se më 22 shtator 2009, Kuvendi Komunal i Klinës nxori vendimin nr. 01NR 351-3187-08 për refuzimin e kërkesës së Parashtruesit për ofrimin e mbështetjes për rindërtimin e shtëpisë së tij për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

7. Parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e ka kundërshtuar vendimin e lëshuar nga Kuvendi Komunal i Klinës. Në vend të kësaj, ai iu drejtua disa institucioneve, siç janë Zyra e Avokatit të Popullit në Kosovë, dhe i kërkoi ato që të ushtrojnë presion në Kuvendin Komunal të Klinës për ta ndihmuar atë në rindërtimin e shtëpisë së shkatërruar gjatë luftës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

8. Parashtruesi i kërkesës ankohet se është shkelur e drejta e tij në kompensim për pronën e shkatërruar gjatë luftës, duke mos saktësuar asnjë dispozitë të veçantë të Kushtetutës.

Komentet e palës kundërshtare

9. Pala kundërshtare, Kuvendi Komunal i Klinës, të cilës i është komunikuar Kërkesa nga ana e Zyrës për regjistrimin e lëndëve e Gjykatës, dorëzoi përgjigjen e saj më 5 janar 2010. Në atë përgjigje, kryetari i Komunës së Klinës theksoi si në vijim "Për sa i përket këtij rasti specifik, çështja e rindërtimit emergjent të pasluftës kryesisht është trajtuar nga organizatat joqeveritare të shteteve të ndryshme, të cilat kishin buxhete vetanake, si dhe kishin kërkesat e palëve dhe materialet tjera për rindërtimin e shtëpive. Prandaj, ne si komunë, nuk kishim qasje apo mundësi të përgatitjes së listës së prioriteteve për përfituesit."

Vlerësimi i pranueshmerisë së kërkesës

10. Për të qenë në gjendje që të gjykojë mbi Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse Parashtruesi i ka përmbushur kushtet e pranueshmerisë të përcaktuara në Kushtetutë.

11. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj";

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton që:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

12. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese thekson që në Kërkesën e tij, Parashtruesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi që tregon se ai e ka kundërshtuar vendimin e lëshuar më 22 shtator 2009 nga ana e Kuvendit Komunal të Klinës me numër Nr 01NR 351-3187-08.

13. Siç është theksuar në Lëndën nr. KI.41/09, Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Vendimi Nr. RK-04/10 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, datë 27 janar 2010), Gjykata dëshiron të theksojë se shkaku themelor i rregullit të shterimit, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës, është që t'i ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë gjykatat, mundësinë e parandalimit apo korrigjuar shkeljen e pohuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni v. Franca, nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngriten shprehimisht në procedurat në fjalë. Përderisa çështja ngritet në mënyrë të nënkuptuar apo në thelb, shterimi i mjeteve përmbushet (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas v. Qipro, nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004).

14. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se parashtruesit e kërkesave kërkojnë që t'i shterin vetëm mjetet që janë në dispozicion dhe efektive. Mjetet diskrecionare apo të jashtëzakonshme nuk kanë nevojë të shteren, për shembull të kërkojnë që gjykata të bëjë revizion të vendimit (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Cinar v. Turqia*, nr. 28602/95, vendimi i 13 nëntorit 2003). Nëse një parashtruesi i kërkesës ka provuar një mjet të cilin Gjykata e konsideron si jo të duhur, koha e shpenzuar për këtë mjet nuk do të ndërpresë vazhdimin e afatit kohor në katërmuajshë (neni 49 "Afatet" i Ligjit), gjë që mund të shkaktojë që ankesa të refuzohet në bazë të skadimit të afatit (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Prystavka, Rezgui v. Franca*, nr. 49859/99, vendimi i 7 nëntor 2000).

15. Për sa i përket rastit aktual, Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar ankesën e tij drejtpërsëdrejti në këtë Gjykatë, duke theksuar se është shkelur e drejta e tij në kompensim për pronën e shkatërruar, duke mos iu referuar asnjë neni të Kushtetutës apo të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

16. Veç kësaj, Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, miratuar më 22 korrik 2005, në Pjesën IX, përcakton që "Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ" (neni 127.2), gjersa "Organi administrativ të cilit i drejtohet ankimi shqyrton ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit të kontestuar" (neni 127.3). Për më tepër, Ligji parasheh që "Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit" (neni 127.4).

17. Megjithatë, Parashtruesi i kërkesës nuk ka vërtetuar në asnjë mënyrë se pse ai mendon se mjetet ligjore, të cekura në Ligjin nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, duke përfshirë ankimin në gjykatat e rregullta, nuk ka qenë në dispozicion dhe, nëse kanë qenë në dispozicion, nuk do të ishin efektive, dhe në këtë mënyrë, nuk ka pasur nevojë të shteren.

18. Në këto rrethana, Parashtruesi i kërkesës, nuk mund të konsiderohet se i ka përmbushur kërkesat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe nenin 55 të Rregullores së Punës, njëzëri,

MERR VENDIM


I. PËR TË REFUZUAR Kërkesën si të papranueshme.

II. Palët do të njoftohen për Vendimin dhe Vendimi do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Mr.Sc.Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

